

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 583 Prot.

Tiranë, më 03.06 2016

VENDIM Nr. 49, datë 20.05.2016

Në mbështetje të **Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore"** (i ndryshuar), **Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008** "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi **Projektin kërkimor shkencor të ri "Kalaja e Pecës-Kukës-Rivlerësimi i gërmimeve të vitit 1985-1989 dhe krijimi i hartës së zonimit arkeologjik"**, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Luan Përzhita,

VENDOSI:

1. Të miratojë **Projektin kërkimor shkencor të ri "Kalaja e Pecës-Kukës-Rivlerësimi i gërmimeve të vitit 1985-1989 dhe krijimi i hartës së zonimit arkeologjik"**, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Luan Përzhita, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Pastrime nga vegetacioni të murit rrethues, kishës me ambientet e saj, godinës rreth murit rrethues, mureve të taracimeve.
 - Zonifikimi arkeologjik i shtrirjes së qytezës me qëllim shpalljen zonë e mbrojtur arkeologjike.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë gusht 2016.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

